



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 521/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani, kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) e cila i drejtohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

Hidhet si e palejuar ankesa numër A-521e datës 13.12.2010 e subjektit politik Fryma e Re

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik FER dega në Prishtinë, e cila i drejtohet KQZ-së, pasi “me date 12.12.2010 në Shkollën Fillore “Ismet Rraci” në Klinë në VV 0801/03R, në listën e votuesve gjendej një person e cila rezulton si e vdekur me emrin Arbëresha Dinaj, edhe pse prindërit e saj kishin kërkuar që të largohet nga lista nuk ishte bërë një gjë e tillë”.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

Ne baze te dispozitave te lartpërmendura, PZAP-i vlerëson se ankesa e FER paraqitur kundrejt KQZ-së në lidhje me largimin nga lista personat të cilët kanë vdekur, nuk është nën juridiksionin e tij.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 521/2010 më datën 15.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Ferit Osmani



[Handwritten signature]